

## NJË VIT PAS PËRFUNDIMIT TË PAVARËSISË SË MBIKËQYRUR: STAGNIMI I KOSOVËS

Përgatitur nga:

**Ilir Deda dhe  
Lulzim Peci**

### HYRJJE

Një vit pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur Kosova e gjen veten në një rrugë qorre. Përfundimi i parakohshëm i pavarësisë së mbikëqyrur, i përshëndetur me sukseset që nuk janë arritur, ka manifestuar përkushtimin dukshëm të zvogëluar të sponsorëve të pavarësisë së Kosovës në përmbushjen e suksesshëm të misionit të dikurshëm të përbashkët Kosovë-Perëndim për legjitimitet të plotë ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Rruga për arritjen e këtij qëllimi është zhvendosur në dialogun e Kosovës me Serbinë, “të lehtësuar” nga BE-ja.

Pas më shumë se pesë vite prej shpalljes së pavarësisë dhe një viti prej përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur, Kosova përballet me dy realitete të ndryshme sa i përket shtetësisë së saj dhe marrëdhënieve të jashtme: atë të entitetit të pavarur dhe tjetrin të shtetit të pavarur dhe sovran. Ajo trajtohet si një entitet i pavarur në marrëdhëniet e saj me institucionet Euro-Atlantike dhe shumicën e shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, derisa Serbia e trajton atë edhe si territor të ndarë që qeveriset nga Rezoluta 1244 e KS të OKB-së edhe si pjesë të veten. Në anën tjetër, Kosova trajtohet si shtet sovran vetëm në nivelin dypalësh nga shtetet që e kanë njohur pavarësinë e saj. Mirëpo ekziston një çekuilibrim ndërmjet fushës dhe intensitetit të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe që pasqyrojnë dobësinë e legjitimitetit aktual ndërkombëtar të Kosovës dhe akomodimin e Perëndimit me politikën “neutral ndaj statusit”.

Marrëveshja e Parë mbi Normalizimin e Marrëdhënieve e arritur në Bruksel në thelb i është nënshtruar konceptit të zgjidhjeve mbi baza një-etnike. Ajo shkon shumë përtej Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin (PGjS) të Ahtisaarit tashmë të harruar dhe shtrun themelin për një karakter të ri binacional të shtetit të ri.

Zbatimi i Marrëveshjes nuk do të çoj kah integrimi i serbëve të Kosovës në shtetin e ri. Më saktë, institucionet dhe kompetencat e reja të Bashkësisë së Komunave Serbe (BKS) do të thellojnë ndarjen ndër-etnike, që kësaj here do të forcohet nëpërmjet shkëputjes institucionale. Me një pranim të përgjithshëm të juridiksionit ligjor të Serbisë mbi vendbanimet dhe komunat e serbëve të Kosovës, për aq kohë sa Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, dhe për aq kohë sa kjo e fundit mbetet jashtë Kombeve të Bashkuara, ka shumë të ngjarë që marrëveshja e ndërmjetësuar nga Brukseli do të jetë një status quo e re dhe një tjetër përpjekje për një ndarje paqësore sesa një përpjekje për të forcuar zotësinë e Kosovës për të funksionuar si një shtet plotësisht i pavarur e i pakontestueshëm ndërkombëtarisht.

Zgjedhjet e ardhshme komunale në Kosovë të 3 nëntorit po ballafaqohen me tri interesa të divergjente që ndërlidhen me këto zgjedhje, në të cilat: BE-ja dhe ShBA-ja i shohin këto zgjedhje si pjesë të zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe kryesisht janë të përqendruar në pjesëmarrjen e serbëve në veri të Kosovës (2 % të zgjedhësve të Kosovës); Serbia i sheh këto zgjedhje si mjet për të themeluar BKS-në dhe ligjërisht e institucionalisht ta legjitimoj praninë e saj në Kosovë përmes fitores së Iniciativës Qytetare Srpska, që është krijuar, financuar dhe sponsorizuar nga ajo; Kosova duhet të

demonstrojë kapacitetin për organizimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente pas zgjedhjeve me shkallë të gjerë të mashtrimeve të dhjetorit 2010, të cilat kanë dëmtuar në mënyrë serioze legjitimitetin e institucioneve qendrore.

Rreziku i këtyre interesave të kundërta është i lartë për gjendjen e përgjithshme të demokracisë në vetë Kosovën. Përsëri vërehet se nuk ka klimë të brendshme politike për të lejuar apo për të mos vënë re mashtrimet e mundshme në zgjedhje. Kjo do të rezultojë me turbullira të thella politike nëse kryhen manipulime dhe ato legjitimohen pas 3 nëntorit. Gjithashtu bojkotimi i mundshëm i gjerë i këtyre zgjedhjeve nga serbët e veriut të Kosovës do të paraqiste një goditje serioze ndaj Marrëveshjes së Brukselit, duke e bërë atë praktikisht të pazbatueshme. Me një rrjedhë të tillë të ngjarjeve, Kosova do ta gjej veten në krizën më serioze politike e institucionale që prej shpalljes së pavarësisë në vitin 2008. Për më tepër, në vitin 2014 Kosova do të përballet me një numër të sfidave serioze që do të përkufizojnë të ardhmen e saj afatmesme – përmbyllja e suksesshme e reformës zgjedhore dhe rregullsia e zgjedhjeve të ardhshme nacionale, transformimi i formatit aktual të dialogut Prishtinë-Beograd që do të varet nga ecuria e bisedimeve për anëtarësim të Serbisë; dhe të gjeturat e Task Forcës së veçantë hulumtuese euro-amerikane mbi trafikimin me organe njerëzore dhe krimin e organizuar.

## **PERËNDIMI DHE LEGJITIMITETI NDËRKOMBËTAR I KOSOVËS: NDRYSHIMI I POLITIKËS**

Që prej përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrtur në shtator të 2012-ës, Kosova ka pranuar 13 njohje të reja, duke e sjellë

numrin e përgjithshëm të njohjeve në shifrën 104. Po ashtu, Kosova është bërë anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në nëntor të 2012-ës; dhe është bërë anëtare e Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) në qershor të 2013-ës. Megjithatë, perspektivat për anëtarësimin e Kosovës në organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara (OKB), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) dhe BE-ja, mbeten të zymta. Përfundimi i parakohshëm i pavarësisë së mbikëqyrur ka treguar mungesën e përkushtimit të sponsorëve të pavarësisë së Kosovës për të parë përmbushjen e suksesshme të legjitimitetit të plotë ndërkombëtar të shtetësisë së Kosovës. Në vend të kësaj, shpresat për arritjen e këtij qëllimi janë zhvendosur në dialogun e Kosovës me Serbinë.

Dialogu Prishtinë-Beograd i “lehtësuar” nga BE-ja, pavarësisht nga Marrëveshja e Brukselit, nuk ka ndryshuar qëndrimin e shteteve mos njohëse të BE-së, ndonëse përgjithësisht pritej që ta arrinte këtë. Ka shumë gjasa që këto pesë shtetet anëtare nuk do të ndryshojnë qëndrimin e tyre kundruall pavarësisë së Kosovës në një të ardhme të afërt.

Legjitimiteti i plotë ndërkombëtar i Kosovës është bllokuar me procesin e anëtarësimin të Serbisë në BE. Në realitet, “normalizimi i marrëdhënieve” mund të zgjas më shumë se një dekadë, respektivisht derisa Serbia të bëhet shtet anëtar i BE-së. Në praktikë, kjo do të thotë se legjitimiteti ndërkombëtar i Kosovës do të varet në masë të madhe dhe ekskluzivisht nga vullneti politik i Serbisë. Faktorët kufizues të këtij procesi janë të vendosur në një mënyrë që për çdo pranim të subjektivitetit ligjor të Kosovës nga

Beogradi, Prishtina duhet të bëjë kompromise në funksionimin e saj të brendshëm dhe arkitekturën e saj institucionale në mënyrë që t’i përmbush kërkesat e Beogradit. Për më shumë, një numër i marrëveshjeve të përkohshme të Brukselit nga dialogu teknik dhe politik, si liria e lëvizjes, telekomunikimi dhe energjia, pritet të negociohen sërish pas skadimit të tyre në vitin 2015 dhe 2016. Ligjërisht, zbatimi i marrëveshjeve të Brukselit nuk ka garanci dhe garant të detyruara ndërkombëtar, por është subjekt i vullnetit të mirë të palëve për t’i zbatuar ato.

Duke i marrë parasysh këta faktorë kufizues, është e parëndësishme nëse Kosova vërtetë do të njihet nga Serbia në fund të shtegut të anëtarësimin në BE të Beogradit. Ecuria me të cilën Kosova është duke kompromentuar funksionimin e saj të brendshëm, në emër të paqes dhe stabilitetit afatshkurtër, do ta gjykojë Kosovën duke e bërë jofunksionale dhe të gjitha shpresat që Kosova nuk do të bëhet Bosnja dhe Hercegovina tjetër në Ballkanin Perëndimor do të shpartallohen, duke kërcënuar paqen dhe stabilitetin afatgjatë.

Faktorët kufizues aktual të “normalizimit të marrëdhënieve” në vend se të përshpejtojnë rrugën e Kosovës kah BE-ja dhe legjitimiteti ndërkombëtar mund të çojnë përkundrazi kah rritja e tensioneve dhe konfliktet e mundshme. Kjo mungesë e përfundimit të qartë të fund-lojës ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është plotësisht në vijë me objektivin strategjik të Beogradit për ndarjen e Kosovës; Prishtina ka mungesë thelbësore të një vizioni të përgjithshëm dhe strategjisë për fuqizimin e shtetësisë së saj; dhe BE-ja dhe ShBA-ja nxitojnë që ta dalin nga Kosova, duke e nënrenduar nevojën për një marrëveshje gjithëpërfshirëse mbi normalizimin ndërmjet dy shteteve në një

proces kryesisht teknik dhe të brendshëm të anëtarësimit të Serbisë në BE.

### NDRYSHIMI I POLITIKËS

Pesë vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kosova përballlet me dy realitete të ndryshme sa i përket shtetësisë së saj dhe marrëdhënieve të jashtme: atë të entitetit të pavarur dhe tjetrin të shtetit të pavarur dhe sovran. Kosova trajtohet si një entitet i pavarur në marrëdhëniet e saj me institucionet Euro-Atlantike dhe shumicën e shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, derisa Serbia e trajton atë edhe si territor të ndarë që qeveriset nga Rezoluta 1244 e KS të OKB-së por edhe si pjesë të veten. Ky është rezultat i përshtatjes konkrete të qëndrimit “neutral ndaj statusit” të këtyre institucioneve, duke përfshirë edhe Kombet e Bashkuara.

Përveç organizatave ndërkombëtare ku Kosova është anëtarësuar si shtet i pavarur (Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, BERZH-i), të gjitha organizatat tjera shumëpalëshe e shohin Kosovën si entitet të pavarur, me ç’rast shumica prej tyre nuk ia lejojnë anëtarësimin Prishtinës. Për më tepër, nëpërmjet “neutralitetit ndaj statusit” Kosova i është bashkuar një numri të kufizuar të organizatave dhe rrjeteve rajonale të Evropës Juglindore. Kosova trajtohet si shtet i pavarur vetëm në nivelet dypalëshe nga shtetet që e kanë njohur pavarësinë e saj.

Megjithatë, pjesa dërmuese e marrëdhënieve të Prishtinës me të tjerët është e përqendruar në nivelin shumëpalësh, kryesisht me BE-në derisa marrëdhëniet dypalëshe janë në nivel shumë më të ulët. Madje edhe shtetet njohëse kanë prirje që të përshtaten me “politikën neutral ndaj statusit” në agjendën shumëpalëshe, kryesisht duke e përforcuar këtë politikë në dialogun e Kosovës me Serbinë, që kësajsoj rezultojnë në një shpresë të

afatgjate pa mbulesë se Kosova një ditë do të njihet nga Serbia, duke përmbyllur kështu çështjen e legjitimitetit ndërkombëtar. Kjo politikë perëndimore ka të meta fundamentale . Ajo e kurthon Kosovën në një shtetësi të papërfunduar në aspektin afatgjatë dhe në një proces të ri-arranzhimit të vazhdueshme të brendshëm për të bërë të pranueshme pavarësinë e Kosovës për Serbinë, përderisa lehtësohet anëtarësimi i Beogradit në BE. Kjo politikë e çekuilibruar e vendos Kosovën në një situatë më të keqe se Bosnjën. Legjitimiteti ndërkombëtar i Bosnjës nuk vihet në pikëpyetje. Përkundrazi, shteti është jofunksional kryesisht për shkak të rregullimit të saj të brendshëm institucional që është sjellë nga ndarja e brendshme e Marrëveshjes së Dejtonit. Kosova ndodhet në një situatë ku në njërin anë shtetësia e saj kundërshtohet ndërkombëtarisht, përderisa brenda pranon bosnjëzimin gradual - duke paguar çmimin për njohjen nga Serbia si entitet i pavarur, por jo si shtet - dhe marrëdhëniet kontraktuale me BE-në.

Në vitin 2008 sponsorët e pavarësisë së Kosovës dhe kryeministri Hashim Thaçi kanë krijuar shpresën e rrejshme se shteti i ri brenda muajve do të merr mbi 100 njohje ndërkombëtare dhe se brenda më së shumti pesë viteve Kosova do të bëhej anëtare me të drejta të plota e Kombeve të Bashkuara. Deri në vitin 2011, ky ishte drejtimi i veprimeve të sponsorëve të pavarësisë dhe i vet Prishtinës. Ishte nisja e dialogut Kosovë-Serbi që e zhvendosi drejtimin e sponsorëve drejt përshtatjes me Kosovën si një “entitet të pavarur” si rezultat i paftësisë për të siguruar mbështetje të plotë ndërkombëtare për njohjen e Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran. Shoku e këtij ndryshimi ende është duke u mbajtur jashtë diskursit të brendshëm publik dhe politik në Kosovë. Kjo më së miri vërehet në atë se si Qeveria e Kosovës ka

bartur veten në dialogun me Beogradin, duke prodhuar pritje të rrejshme dhe duke pranuar bashkë qeverisjes me Serbinë mbi serbët e Kosovës, pa një zgjidhje të qartë të marrëdhënieve dypalëshe me Beogradin. Tutje, pandëshkueshmëria dhe korrupsioni alarmant e krimi në nivelet më të larta politike të qeverisjes në Prishtinë dhe dëshpërimi ekonomik ka rezultuar në një ulje dramatike të besimit në shtetësi nga vet kosovarët. Këto rrethana kanë krijuar një mjedis, ku po qe se nuk ka ndonjë ndryshim në aspektin afatmesëm sa i përket statusit ndërkombëtar të Kosovës - anëtarësimi në OKB, atëherë kërkesat për shpërbërjen e shtetit dhe bashkimin me Shqipërinë do të bëhen pjesë e diskursit të përgjithshëm politik që nuk do të jetë i kufizuar vetëm të Lëvizja “Vetëvendosje!” (VV).

## **FUNDI I SHTETIT SHUMETNIK: NDARJA PËRBALLË INTEGRIMIT**

Më 19 prill 2013 pas 10 raundeve të dialogut politik në Bruksel nën kujdesin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Catherine Ashton, kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi dhe Ivica Daçiç sigluan “Marrëveshjen e Parë të Parimeve Qeverisëse të Normalizimit të Marrëdhënieve” ndërmjet dy vendeve. Marrëveshja e parë i është nënshtruar konceptit të zgjidhjeve mbi baza mono-etnike. Ajo krijon një ndarje institucionale etnike ndërmjet serbëve të Kosovës dhe të tjerëve dhe paraqet një goditje ndaj përpjekjeve 14 vjeçare të bashkësisë ndërkombëtare për të ndërtuar një Kosovë si shoqëri dhe shtet shumetnik. Ajo shkon shumë përtej Propozimit Gjithëpërfshirës të Statusit (PGJS) të Ahtisarit, duke e interpretuar në mënyrë kreative, dhe vendos themelin për një karakter të ri të shtetit të ri. Përderisa PGJS-ja ofroi themelin për një shoqëri dhe shtet

shumë-etnik, Marrëveshja e Parë e Brukselit e ka transformuar karakterin e Kosovës në një shtet të papërfunduar bi-nacional.

Marrëveshja krijon de-facto një qeveri të serbëve të Kosovës (Asociacioni/Bashkësia e komunave serbe në Kosovë) me garancitë ligjore që janë në konflikt me ligjin në fuqi të Kosovës dhe ligjin kushtetues të Serbisë<sup>1</sup>. Në situatën ku Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, garancitë ligjore të Serbisë do ta bëjnë Asociacionin/Bashkësinë një organ institucional dhe administrativ besnik ndaj Beogradit dhe funksional brenda autoritetit të Prishtinës. Ky organ i ri qeverisës do të funksionoj në kuadër të një statusi hibrid, ku legjitimiteti i tij ligjor dhe funksional buron nga dy Kushtetuta kundërtëne. Kjo do të thotë sovranitet të përbashkët dhe bashkë qeverisje të Kosovës dhe Serbisë mbi serbët e Kosovës.

Kjo Marrëveshje e Parë gjithashtu ka treguar se paaftësia e institucioneve qendrore të Kosovës për të ndërtuar një partneritet të vërtetë me serbët e Kosovës në jug të lumit Ibër i ka ndëshkuar ata për procesin e papërfunduar të decentralizimit dhe drejtpërdrejtë ka pasqyruar mbi paaftësinë dhe/ose mungesën e vullnetit si nga ana e udhëheqësisë shqiptare të Kosovës ashtu edhe nga prania ndërkombëtare për nisjen e ndërtimit të institucioneve të vërteta shumetnike. Në fund të fundit, i është nënshtruar tutelës së Beogradit dhe investimit 14 vjeçar të Serbisë për të mbajtur të ndarë serbët e Kosovës nga Prishtina.

Kapitulli X i Kushtetutës së Kosovës, neni 124 përfshin dy mënyra të veçanta dhe reciprokisht të ndara të bashkëpunimit komunal që buron nga Plani i Ahtisaarit<sup>2</sup>. E

<sup>1</sup> Pika 2 e “Parimeve Qeverisëse të Normalizimit të Marrëdhënieve”

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli X, neni 124 (Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial)

para është nëpërmjet të *asociacionit të komunave*, dhe e dyta nëpërmjet *partneriteteve komunale*. Asociacioni i komunave mund të krijohet nga komunat për të ofruar trajnime, ngritje të kapaciteteve, ndihmë teknike dhe hulumtime e rekomandime lidhur me kompetencat komunale.<sup>3</sup> Asociacioni është organizatë jofitimprurëse.<sup>4</sup> Prandaj, asociacioni ofron shërbime, organizon dhe koordinon aktivitetet e anëtarëve të asociacionit, përderisa promovon dhe bashkëpunimin ndër-komunal. E dyta, partneritetet komunale, mund të formohen ndërmjet dy apo më shumë komunave për të ofruar shërbime të përbashkëta.<sup>5</sup> Nëpërmjet partneriteteve komunat mund të bashkëpunojnë në kompetencat e tyre *vetanake* dhe të *zgjeruara*, por jo edhe në ato të *deleguara*.<sup>6</sup> Kësisoj, nëpërmjet partneriteteve komunat mund të ushtrojnë në mënyrë të përbashkët kompetencat dhe të ofrojnë shërbime të përbashkëta, por jo nëpërmjet të asociacionit të komunave. Marrëveshja e Parë ka bashkuar dy mënyrat e bashkëpunimit komunal, asociacionin dhe partneritetet, duke lejuar në mënyrë të qartë komunat serbe të Kosovës që kolektivisht të ushtrojnë qeverisjen e përbashkët nëpërmjet të Bashkësisë së komunave serbe, në kompetencat vetanake, të zgjeruara dhe ato të deleguara.

Marrëveshja e Parë liston pesë kompetencat e veçanta ekzekutive të Bashkësisë së Komunave Serbe në zhvillimin ekonomik, arsim, shëndetësi dhe planifikim urban e rural. BSK do të ketë rol vendimtar në emërimin e komandantit rajonal për një rajon

të ri të Kosovës veriore, të përbërë nga katër komuna me shumicë serbe të Kosovës në veri të lumit Ibër, ku katër kryetarët e komunave do të ofrojnë një listë në emër të BKS-së. BKS-ja do të udhëhiqet nga Statuti i BKS-së; do të ketë Kryetarin, Nënkryetarin, Kuvendin dhe Këshillin (përfaqësuesit e këtyre strukturave do të zgjedhën pas mbajtjes së zgjedhjeve komunale në veri të Kosovës); BSK-ja mund të shpërbehet vetëm me një vendim të komunave pjesëmarrëse.<sup>7</sup>

Përpos këtyre kompetencave, BSK-ja do të ketë edhe rol përfaqësues si entitet i ndarë në institucionet qendrore të Kosovës dhe për këtë qëllim do të ketë një vend të ndarë në Këshillin Konsultativ për Komunitete të Presidencës së Kosovës, duke përfshirë edhe funksionin mbikëqyrës. Gjithashtu, BSK-ja do të punoj me “Fondin për Veriun”, bashkë me BE-në dhe Qeverinë e Kosovës; do të pranoj financim të ndarë nga Serbia, do të pranoj kompetenca shtesë nga Beogradi pasi që Beogradi të miratoj/plotësoj ligjin e vet kushtetues. Tutje, në veri të Kosovës do të ketë një kompani të re energjetike<sup>8</sup> që do të furnizoj energjinë elektrike, të ofroj shërbimet e shpërndarjes për konsumatorët në katër komunat me shumicë serbe në veri dhe do të jetë në gjendje që të blej dhe shes rrymë në tregun e lirë, e pavarur nga KEDS-i në Prishtinë. Në telekom, i tërë territori i BSK-së së ardhshme dhe vendbanimet tjera të serbëve të Kosovës do të mbulohen nga kompanitë e ndara, vartëse të Serbisë, në telefoninë fikse dhe mobile.<sup>9</sup>

Në gjyqësor, Marrëveshja kërkon krijimin e një divizioni të Gjykatës së Apelit me seli të

<sup>3</sup> Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; neni 32.3

<sup>4</sup> Statuti i Asociacionit të Komunave të Kosovës, neni 2.1

<sup>5</sup> Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, neni 29

<sup>6</sup> Ligji mbi Bashkëpunimin Ndër-komunal, Nr. 04/L-010, Kapitulli 1, neni 2, 3.

<sup>7</sup> Ndryshe Asociacioni i Komunave të Kosovës mund të shpërbëhet me 2/3 e Kuvendit të Asociacionit ose nga institucioni shtetëror që e ka regjistruar Asociacionin, në rastin kur anëtarët e Asociacionit nuk janë aktivë për një vit ose më shumë.

<sup>8</sup> Shih Marrëveshjen lidhur me Energjinë, pikat 4,5

<sup>9</sup> Shih Marrëveshjen lidhur me Telekomunikimet, pikat 3, 4.

përhershme në Mitrovicë të veriut, të përbërë nga gjyqtarët dhe personeli administrativ. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të themeloj një panel të përbërë nga shumica e gjyqtarëve serbë të Kosovës, për t'u marrë ekskluzivisht dhe veçanërisht me të gjitha 10 komunat me shumicë serbe. Ndarja në shkallën e dytë të gjyqësorit krijon de-facto Gjykatën e Apelit të serbëve të Kosovës.

Në polici Marrëveshja krijon një rajon policor në veri të dominuar etnikisht nga serbët që përbëhet nga katër komuna: Mitrovica Veri, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi; me një serb të Kosovës komandant rajonal të policisë në Kosovën veriore. Ndryshe nga komandantët e tjerë rajonal, komandanti rajonal serb i Kosovës do të propozohet nga katër kryetarët e komunave në emër të BKS-së dhe do të emërohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, jo në përputhje me Ligjin aktual për Policinë i cili përcakton se juridiksionet territoriale të rajoneve policore janë të krijuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës (DGJ), i cili gjithashtu zgjedh drejtorët rajonal.<sup>10</sup>

Duke marrë para sysh masat e reja institucionale që Marrëveshja e Parë parashikon, nuk ka të ngjarë që zbatimi i saj do të çojë kah integrimi i serbëve të Kosovës në shtetin e ri. Më shumë ka të ngjarë që institucionet e reja do të thellojnë ndarjen ndëretnike, këtë herë të forcuar përmes ndarjes institucionale. Me një juridiksion të Serbisë mbi vendbanimet dhe komunat serbe në Kosovë, përderisa Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, dhe përderisa kjo e fundit mbetet jashtë Kombeve të Bashkuara, më shumë ka të ngjarë që marrëveshja e ndërmjetësuar nga Brukseli të jetë një status quo dhe një tjetër përpjekje për një ndarje paqësore se sa një përpjekje për ta forcuar

zotësinë e Kosovës për të funksionuar si një shtet i pavarur dhe shumetnik. Kjo është në përputhje të plotë me politikën kohezive të Serbisë për ndarjen e Kosovës, duke forcuar qasjen e re të Beogradit në ndryshimin e mjetit për arritjen e qëllimit të kahmotshëm të tij.

## KOSOVA NË PASQYRËN E THYER

Kosova do të mbajë zgjedhjet e saj lokale më 3 nëntor. Ekzistojnë tri interesa të ndryshme të ndërlydhura me këto zgjedhje: i) BE-ja dhe ShBA-ja i shohin këto zgjedhje si pjesë të zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe kryesisht janë të përqendruara në pjesëmarrjen e serbëve në veri të Kosovës (2 % të zgjedhësve të Kosovës); ii) Serbia i sheh këto zgjedhje si mjet për të themeluar BKS-në dhe ligjërisht e institucionalisht ta legjitimoj praninë e saj në Kosovë përmes fitores së Iniciativës Qytetare Srpska, që është krijuar, financuar dhe sponsorizuar nga ajo; dhe iii) Kosova duhet të demonstrojë kapacitetin për organizimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente pas zgjedhjeve me shkallë të gjerë të mashtrimeve të dhjetorit 2010, të cilat kanë dëmtuar në mënyrë serioze legjitimitetin e institucioneve qendrore.

Rreziku i këtyre interesave të kundërta është i lartë për gjendjen e përgjithshme të demokracisë në vetë Kosovën. Nuk ka klimë të brendshme politike për të lejuar apo për të mos vënë re mashtrimet e mundshme në zgjedhje. Kjo do të rezultojë me turbullira të thella politike nëse kryhen manipulime dhe ato legjitimohen pas 3 nëntorit. Gjithashtu bojkotimi i mundshëm i gjerë i këtyre zgjedhjeve nga serbët e veriut të Kosovës do të paraqiste një goditje serioze ndaj Marrëveshjes së Brukselit, duke e bërë atë praktikisht të pazbatueshme. Me një rrjedhë të tillë të ngjarjeve, Kosova do ta gjej veten

<sup>10</sup> Ligji i Policisë, Nr. 03/L-035, neni 32, 33.

në krizën më serioze politike e institucionale që prej shpalljes së pavarësisë në vitin 2008.

Kosova në esencë është duke u qeverisur nga strukturat dhe vendimmarrja joformale. Poashtu, ekziston një kontroll i shprehur i Qeverisë mbi gjyqësorin, prokurorinë, policinë dhe ekonominë.

Ky mjedis i zymtë socio-ekonomik po keqësohet edhe më tej, me shkallën e papunësisë që qëndron në 35,1%, shkallën e varfërisë në 29,7%<sup>11</sup> dhe rritjen ekonomike prej 2,6%<sup>12</sup>, kryesisht për shkak të punëve publike të qeverisë dhe jo zhvillimit të ekonomisë private, e cila është në rënie. Në ndërkohë, Kuvendi i Kosovës është jofunksional, ku në njërin anë QeK ka humbur shumicën në Kuvend, por qëpo mbahet në pushtet nga “mbikëqyrësit e padukshëm”, Quinti, për shkak të dialogut me Beogradin, derisa në anën tjetër Kuvendi nuk është në gjendje ta ushtrojë rolin e tij mbikëqyrës. Edhe degët e pavarura të Qeverisë janë ose të kontrolluara nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në pushtet ose janë jofunksionale. Edhe vetë Qeveria është duke shfaqur shenja të kaosit të brendshëm, vendimet janë të përqendruara në mënyrë të plotë në duart e Kryeministrit Hashim Thaçi dhe një numri shumë të vogël të njerëzve rreth tij, derisa shumica e ministrive funksionojnë pa ndonjë drejtim dhe koordinim.

Në ndërkohë, partitë opozitare – Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dhe Lëvizja

<sup>11</sup> Shih UNDP Kosovë <http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/countryinfo/>. Të dhënat e UNDP-së kanë qenë më të sakta, pasi që ka një mospërputhje ndërmjet Agjencisë së Statistikave të Kosovës që deklaroi se papunësia është 30%, derisa Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale deklaroi se është 43%.

<sup>12</sup> Shih FMN <http://www.imf.org/external/country/UVK/index.htm>

VETËVENDOSJE (VV) kanë treguar paaftësi për ta ndërruar Qeverinë dhe për të siguruar një alternativë për transformimin demokratik dhe ekonomik të Kosovës. LDK dhe AAK janë parti inerte, duke e ruajtur PDK-në për të mos rënë nga pushteti në kohë kritike, në të njëjtën kohë duke garuar me njëra tjetrën se cila do ti bashkohet PDK-së në qeverisjen e ardhshme. VV e ka ngulitur veten në një kuti ideologjike dhe në momente të caktuara në aksione të dhunshme politike, duke e bërë vetën një cak të lehtë për tu portretizuar si një alternativë jo e shëndoshë për ndryshim në Kosovë. Në realitet, në vend të partive opozitare, mediat e pavarura, disa organizata të shoqërisë civile dhe Komisioni i BE-së përmes Raporteve të tij të Progresit, janë bërë institucionet më të besueshme mbikëqyrëse sa i përket zhvillimeve të brendshme në Kosovë, dhe e kanë marrë rolin mbikëqyrës të opozitës.

Derisa institucionet e Kosovës nuk kanë treguar ndonjë përkushtim të rëndësishëm për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, EULEX-i nën udhëheqjen e diplomatit gjerman Bernd Borchard ka marrë një numër të hapave për ta ndalur krimin. Për ironi, gjatë këtyre ndryshimeve Qeveria e Kosovës ka kërkuar tërheqjen e EULEX-it, në kohët kur zyrtarë të lartë të QeK dhe pothuajse një e treta e deputetëve të Kuvendit janë nën hetime për krim të organizuar dhe korrupsion. Në këtë drejtim, politika e kohëve të fundit e PDK-së në pushtet për tërheqjen e EULEX-it është në përputhje të plotë me atë që VV ka kërkuar me vite. Si me shumë veprime politike, QeK e ka vërtetuar se është amatore në politikë. Tërheqja eventuale e EULEX-it pa ndryshimin e Rezolutës 1244 të KS të OKB-së do ta ri-vendoste autoritetin e UNMIK-ut mbi sundimin e ligjit në Kosovë.



Elita politike e Kosovës nuk ka pasur vullnet dhe aftësi që së bashku ta prodhojë një vizion dhe strategji për tu marrë me sfidat e rëndësishme të tanishme dhe të ardhshme vendore dhe ndërkombëtare me të cilat shteti i ri do të ballafaqohet vitin e ardhshëm. Stabiliteti i qeverisjes në Kosovë do të varet kryesisht nga rezultati dhe rregullsia e zgjedhjeve të 3 nëntorit.

Bazuar në këto rezultate, PDK mund ta përsërisë krizën institucionale të 2010-ës, duke e rrëzuar veten nga pushteti dhe të thërras zgjedhjet e jashtëzakonshme, pa reformë zgjedhore. Gjithashtu, nuk ka marrëveshje në mes të Prishtinës dhe Beogradit mbi kushtet e Serbisë për të mbështetur pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në zgjedhjet qendrore.

Njëri nga parakushtet e rëndësishme për Beogradin është krijimi dhe funksionimi i BKS-së, statuti i së cilës do të diskutohet dhe nënshkruhet në Bruksel pas zgjedhjeve lokale të Kosovës. Bashkë me statutin e BKS-së, Serbia është e obliguar të dekretoj një ligj kushtetues me të cilin ajo do të garantojë ekzistencën e BKS-së, do ta inkorporojë BKS-në në kornizën ligjore dhe do t'ia "transferoj fuqitë" BKS-së, një varg autoritetesh duke u zëvendësuar me statutin e ardhshëm të BKS-së. Kjo do të sigurojë një kapelë të dytë në funksionimin e BKS-së, ku ai do të sigurojë autoritet edhe nga ligji kushtetues i Serbisë edhe nga statuti i miratuar nga Prishtina dhe Brukseli.

Pjesa më e madhe e vitit 2014 do të jetë vit zgjedhor në Kosovë, Serbi dhe BE. Si Kosova ashtu edhe Serbia do të mbajnë zgjedhje të reja qendrore, dhe po ashtu janë zgjedhjet e rregullta për parlamentin e BE-së, i cili më vonë do të zgjedhë Komisionin e ri të BE-së. Është evidente që do të ketë një vakuum në dialog, por gjithashtu edhe një ndryshim të "adresës" së lehtësuesit – nga

Përfaqësuesja e Lartë të DP për Zgjerim. Zhvendosja e dialogut nga një nivel i lartë politik në një nivel teknik normalizimi për "zgjerim" është i parakohshëm, duke marrë parasysh mungesën e një marrëveshje gjithëpërfshirëse mbi normalizimin mes Kosovës dhe Serbisë. Tutje, një ndryshim i tillë ka shumë të ngjarë të shkaktoj jo-stabilitet dhe tensione në vend të përmirësimit të marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Duke e lidhur normalizimin e marrëdhënieve për negociatat e anëtarësimit të Serbisë në Kapitullin 35, Kosova bëhet një peng i prioriteteve politike të Beogradit më shumë se sa një nevojë për një normalizim të hershëm të marrëdhënieve. Prioriteti i BE-së në anën tjetër, është së pari të hap Kapitujt 35, 23 dhe 24 dhe ti mbyll ata në fund të bisedimeve për anëtarësim, të cilat mund të zgjasin për një dekadë. Kjo e vendos Kosovën në një proces dhjetëvjeçar të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, që nuk varet drejtpërdrejt nga Prishtina, duke e përjashtuar faktikisht nga të qenit faktor në përcaktimin e të ardhmes së saj.

Task Forca e Veçantë Hulumtuese euro-amerikane do të përfundojë hetimin e saj mbi trafikimin e organeve njerëzore dhe krimin e organizuar kah fundi i 2013-ës. Këto gjetje dhe aktakuzat e mundshme do të prezantohen në fillimin të 2014-ës. Ajo do ta formësojë dhe do të vendosë të ardhmen e Kryeministrit Hashim Thaçi. Në një mënyrë a një tjetër, Kosova do të ndikohet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nga gjetjet e Task Forcës. Në aspektin vendor, paditë eventuale do të ndryshojnë skenën politike, ndërsa mungesa e tyre do të mbajë trendin e tanishëm politik. Në aspektin ndërkombëtar, aktakuzat eventuale do të dëmtonin rëndë besueshmërinë e Kosovës në kërkesën e saj për legjitimitet të plotë ndërkombëtar.

## PËRFUNDIMI

Kosova duhet të hyjë në një fazë ku do të fillojë seriozisht të përqendrohet në sfidat e brendshme urgjente si demokratizimi, sundimi i ligjit dhe luftimi i suksesshëm i krimit të organizuar e korrupsionit, rigjallërimi i ekonomisë, si dhe procesi i anëtarësimit në BE. Ajo gjithashtu duhet ta gjejë një mënyrë për të ndërtuar një partneritet kuptimplotë me EULEX-in për të forcuar gjyqësinë dhe prokurorinë vendore dhe së bashku me Brukselin të planifikojnë etapa të qarta për përfundimin e pranisë së EULEX-it dhe largimin e tij nga vendi. Me NATO-n, po ashtu do të duhej të zhvillojë një udhërrëfyes të hollësishëm për zvogëlimin e KFOR-it dhe pjesëmarrjen efektive në instrumentet e Partneritetit për Paqe.

Kosova nuk e ka luksin, kohën dhe kapacitetin për të humbur edhe një tjetër dekadë për të siguruar legjitimitetin e saj të plotë ndërkombëtar dhe funksionalitetin e shtetit. Procesi aktual i “normalizimit të marrëdhënieve” i cili është i kyçur dhe i varur drejtpërdrejt nga anëtarësimi i Serbisë në BE në përgjithësi është një pasqyrim i paaftësisë së BE-së për zgjerim në Ballkanin Perëndimor, se sa kapaciteti i BE-së për të stabilizuar rajonin. Dialogu me Beogradin e ka zhvendosur përqëndrimin vendor nga

reformat e nevojshme urgjente në Kosovë. Nëse procesi aktual vazhdon siç parashikohet tani, ai do të forcojë dyshimin në rritje lidhur me realizueshmërinë e Kosovës së pavarur gjatë dekadës së ardhshme; do ta vazhdojë politikën e ndarjes së Kosovës dhe shteteve tjera në rajon; dhe do të paraqes kërcënim direkt për stabilitetin e përgjithshëm të Ballkanit Perëndimor.

Prandaj, procesi aktual i dialogut me Beogradin duhet të përfundojë dhe të ndryshojë në mënyrë domethënëse më 2014. Ky proces duhet të prodhojë një rezultat të menjëhershëm të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse afatgjate mbi përcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe në mënyrë eksplicite të lejojë anëtarësimin e plotë të Kosovës në OKB. Çështja e pavarësisë së Kosovës do të vjetrohët për shtetet mos-njohëse të BE-së, dhe do të jetë një çështje e hapur dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një marrëveshje e tillë gjithëpërfshirëse do ta mundësojë më shpejtë anëtarësimin e Serbisë në BE, ta pastrojë rrugën për anëtarësimin e Kosovës në BE, dhe stabilizimin përfundimtar të Ballkanit Perëndimor. Ajo gjithashtu do të mundësojë që shtetet e Ballkanit Perëndimor të fillojnë bashkëpunimin në interesat e përbashkëta dhe të përfitojnë në fushat e njëjta.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave  
Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Telefoni dhe Faksi: +381 38 227 778  
[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

E drejta autoriale © 2013 e KIPRED-it. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit. Ju lutem kontaktoni [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) apo +381 38 227 778.

Ky projekt është mbështetur nga: Balkan Trust for Democracy (BTD)

**B | T | D** The Balkan Trust for Democracy  
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Përmbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si qëndrime të BTD-së.